

**LIGJ**  
**Nr.9935, datë 26.6.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8360, DATË 10.6.1998 “PËR KRITERET DHE MËNYRËN E SHPËRNDARJES SË PASURISË SË PERSONAVE JURIDIKË, JOBANKARË, QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në ligjin nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurisë së personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, në nenin 8, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për shpërndarjen e vlerave pasurore të secilit kreditor ngarkohet banka e përzgjedhur nga grupi mbikëqyrës i shoqërive huamarrëse, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, e cila duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a) Të ofrojë interesa më të lartë për kapitalet e depozituara për shpërndarje.
- b) Të ofrojë një pagesë më të ulët komisioni bankar për shërbimin e kryerjes së pagesës për çdo kreditor.
- c) Të ketë shtrirje territoriale, me njësi bankare, në qytetet kryesore të vendit.
- ç) Të ofrojë depozitë më të madhe financiare, si garanci bankare, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5798, datë 10.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**